

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Summer 7-2010

### Financimi i biznesit privat në Kosovë

Pleurat Konjufca

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Konjufca, Pleurat, "Financimi i biznesit privat në Kosovë" (2010). *Theses and Dissertations*. 2498.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2498>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**Financimi i biznesit privat në Kosovë**  
Bachelor Degree

Pleurat Konjufca

Korrik/2010  
Prishtinë



Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Tema e Diplomës  
Viti Akademik 2007/2008

Pleurat Konjufca

**Financimi i biznesit në Kosovë**

Mentori: Arton Celina

Korrik/2010

This thesis is submitted in partial fulfillment of the requirements for a  
Bachelor Degree

## Table of Contents

Abstrakti.....	4
Hyrje .....	5
Shqyrtimi I literaturës .....	7
Kuptimi mbi financimin.....	9
Disa nga pengesat në afarizmin e NVM-ve dhe problemi që vihet re në financim ..	12
Problemet e bankierëve në lidhje me financimin e NVM-ve.....	13
Pengesat e përdoruesve në lidhje me kredinë .....	13
Metodologjia.....	15
Mbledhja dhe Analiza e te Dhënave .....	16
Bankat Komerciale.....	18
Institucionet Mikro Financiare.....	20
Përfundimi.....	22
Shtesat.....	26
Cilat janë alternativat e financimit bankar? .....	26
Burimet alternative të financimit të ndërmarrjeve .....	29
Engjujt e biznesit - “Business angels” .....	30
Literatura e shfrytëzuar dhe e konsultuar.....	32

## Abstrakti

Qëllimi I këtij punimi është të kuptojmë ndikimin e kredive në shtimin e numrit të punëtorëve në ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit.

Duke pasur parasysh numrin e madh të të papunëve në Kosovë ne do të mundohemi të kuptojmë se cfar ndikimi kanë kreditë në rritjen e numrit të punëtorëve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit.

Ne në fillim filluam të marrim informata të përgjithshme në lidhje me financimin e biznesit në Kosovë, mirëpo me formulimin e pyetësorit dhe me intervistat e bëra ne arritëm të kuptojmë se cfar vëshirësi kanë ndërmarrjet që ti përmbushin nevojat e veta dhe kuptuam se cfar ndikimi ka marrja e kredisë në shtimin e numrit të punëtorëve.

Kuptuam edhe se ka ndërmarrje që kanë marrur kredi për të zhvilluar me tutje afarizmin e tyre dhe pas marrjes së kredisë kanë falimentuar.

Ne me këtë hulumtim kuptuam edhe rolin e institucioneve mikro-financiare, qka kanë të përbashkët me bankat dhe cila është më e favorshme banka apo institucionet mikro-financiare për marrjen e kredive nga ndërmarrjet.

## Hyrje

Sot në shumë shtete të zhvilluara dhe në ekonomi të tregut të avancuar, bizneset e vogla dhe të mesme paraqesin bazën kryesore të zhvillimit ekonomik. Asnjë shtet apo qeveri nuk mund të ndërtoj një strukturë të fortë ekonomike dhe një zhvillim të ekonomisë moderne pa mbështetjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Roli dhe rëndësia e biznesit të vogël dhe të mesëm ka tërhequr vëmendjen e akademikëve, ekonomistëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Bizneset e vogla dhe të mesme, sikurse edhe në cdo vend tjetër me ekonomi (bashkohore) të tregut edhe në Kosovë po luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në krijimin e një baze të qëndrueshme dhe afatgjate për zhvillim.

Në këtë punim të diplomës qëllimi kryesor është që të pasqyrohet ndikimi i kredive të bankave në shtimin e numrit të punëtorëve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sektorit privat në komunën e Lipjanit.

Financimi është forca bazike motorrike për cdo biznes. Ai është burim i rritjes, sepse mbështet strategjitë eksplicite konkurruese të menaxhmentit dhe bazohet në plane të kujdeshme për fushat ekzistuese ose për fonde të reja.

Firmat e suksesshme cdo vit kryejnë vlerësime kritike lidhur me portfolin e financimeve ekzistuese, në mënyrë që të shohin performancat aktuale të tyre, perspektiven e cdo produkti dhe shërbimi dhe nivelin e realizuar të tyre në krahasim me politikat operative dhe strategjike të përcaktuara nga menaxhmenti.

Gjatë procesit të planifikimit dhe formulimit të buxhetit kapital, menaxhmenti zgjedh ndërmjet më shumë mundësive të ndryshme të financimeve të reja nga të cilat pret të siguroj kthimet e pritshme. Niveli i kthimit në përgjithësi është i lidhur me pritjet e pronarëve dhe me koston e kapitalit. Prandaj, një financim do të shërbej si instrument i rritjes ekonomike dhe do të zmadhoj vlerën e aksioneve, në qoftëse kryhet me kujdes dhe sipas standardeve dhe metodave të përcaktuara. Gjatë vendosjes lidhur me financimin, firma ka parasysh performancat e teknologjisë, reagimin e konsumatorëve, situatën ekonomike dhe zhvillimin teknologjik.

Vendimi për të financuar merret vetëm pasi të jenë diskutuar dhe analizuar njëkohësisht disa projekte për cdo objekt. Po kështu, për të financuar në një projekt zakonisht përdoren burime të ndryshme financiare. Përrjashtim bëjnë rastet kur kemi të bëjme me investime publike nga burimet buxhetore. Vendimi për financim, I cili përfshin parashikimet për mjete të reja, për projekte hulumtuese dhe zhvillimore, programe të marketingut, kapital plotësues punues, investime në instrumente financiare, merret duke krahasuar efektet e resurseve të shpenzuara tani dhe pritjet e përfitimeve të ardhshme nga këto investime.

## Shqyrtimi I literaturës

Në literaturën e sotme, qoftë ajo e vendit apo e huaj e hasim shumë termin ndërmarrje të vogla dhe të mesme ( NVM ). Ndërsa, përkufizimi I këtij biznesi në asnjërin nga këto literatura nuk është bërë në mënyrë të plotë, sepse nuk ka pajtueshmëri rreth asaj se cilat janë kriteret që e përcaktojnë një ndërmarrje për të qenë e vogël apo e mesme. Mirëpo, kriteri më I përgjithshem për klasifikimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është numri I të zënëve në punë. Duke u nisur nga ky kriter në një rast thuhet ‘‘biznesi I vogël është çfarëdo lloji I biznesit në të cilin pronari ose drejtori është në gjendje që të mbaj në mend emrat e punonjësve të tij’’. ( K.Bombek).

Një biznes I vogël është ai që mbizotron në fushën e tij të veprimit dhe që plotëson disa standarde madhësie, porsa I përket punonjësve dhe marrjeve vjetore. ( L.Hoxheta ).

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ( NVM ) definoohen si një biznes që mbizotërohet dhe vepron në mënyrë të pavarur dhe nuk dominon në fushën e tij të veprimit.(Small business size standards). Bazuar në këto përkufizime shihet se kriteri më I shpeshtë që përdoret rreth përcaktimit të madhësisë së ndërmarrjeve është numri I punëtorëve.

Nga kjo mund të rrjedh definimi I NVM-ve ( Definition of small and medium-size enterprise adopted by commission, official journal of the European Communities N.o L 107/8).

1. Mikrondërmarrjet ( micro-enterprise ) kanë deri në 9 punëtorë, me orar të plotë ose gjysmë orar të kohës së punës.

2.Ndërmarrjet e vogla ( small-enterprise) kanë:

- Deri 49 punëtorë, me kohë të plotë ose gjysmë orari
- Qarkullim vjetor jo më të lartë se 7 milion euro, ose
- Bilancin vjetor të gjendjes jo më të lartë se 5 milion euro
- Pasuria maksimale e poseduar nga një pronarë ose nga pronarët e përbashkët nuk mund të kaloj 25% të pasurisë të tërësishme.

3. Ndërmarrjet e mesme ( medium-enterprise ) janë ato ndërmarrje që:

- Kanë deri 249 të punësuar me kohë të plotë apo me gjysmet orari.
- Kanë qarkullim mesatar vjetor jo më shumë se 40 milion euro
- Kanë bilanc vjetor të gjendjes jo më të lartë se 27 milion euro
- Plotësojnë kriterin e pavarësisë ( një apo më shumë ndërmarrje bashkarisht nuk kanë mbi 25% të kapitalit dhe të drejtës së votës.



Viti	2003	2004	2005	2006	18/06-2007
Numri i ndërmarrjeve	27 920	39 257	50 591	55 884	59 156

- Tabela:1, Numri i NVM-vë sipas viteve
- Ky numër i NVM-ve, kishte këtë strukturë të te punësuarve:

Kategoritë sipas numrit të punëtorëve	Numri i bizneseve (18.06. 2007)		Numri i të punësuarve	
1 – 9	58113	98.24%	95.931	55.90%
10-49	882	1.49%	15.436	8.99%
50 - 249	124	0.21%	12.664	7.38%
250 - ....	37	0.06%	47.578	27.72%
Gjithsej	59156	100.00%	171.609	100.00%

Tabela 2: Struktura e të punësuarve në NVM-e,  
Burimi: Anketa e MTI “Hulumtimi i NVM”

Komisioni europian në vitin 1996 ka përcaktuar termin biznes I vogël dhe I mesëm ( SME ). Sipas këtyre kriterëve, si ndërmarrje të vogla dhe të mesme definohe të gjitha ato që kanë më pak se 250 punëtorë, kurse klasifikimi I tyre bëhet në mikrondërmarrje, ndërmarrje te vogla dhe të mesme.

Ndërsa në Kosovë madhësia e ndërmarrjeve ende nuk është përcaktuar me ndonjë kriter të vecantë. Nëse e marrim numrin e punëtorëve, në Kosovë në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve të rexhistruara deri në fund të vitit 2003 ( Sipas ESK ), mbizotërojnë mikrondërmarrje me pjesëmarrje 90%, ndërsa ndërmarrjet e mesme me pjesëmarrje afër

7 %. Pavarësisht në dallim rreth asaj se cka është ndërmarrje e vogël apo e mesme, gjithëherë duhet të kemi parasysh se madhësia e ndërmarrjes nuk është e barabartë me prodhimin e saj apo fuqinë e saj tekniko-ekonomike, ngase mund të gjenden ndërmarrje të cilat sipas kriterëve të zakonshme konsiderohen si të vogla, ndërkaq ato për nga fuqia tekniko-ekonomike janë më të fuqishme se ndonjë ndërmarrje e mesme apo ndoshta edhe më e madhe.( Produzetnicki menadzement, Zagreb,1999).

## Kuptimi mbi financimin

Punët financiare ose financat, mund të kenë një rëndësi vendimtare për zhvillimin dhe ekzistimin e çdo ndërmarrje. Kjo ka të bëjë veçanërisht me ndërmarrjet në kushtet bashkëkohore të veprimit ekonomik. Kur bëhet fjalë për kapitalin, nuk bëhet fjalë vetëm për shtimin e kapitalit të ndërmarrjes, por edhe për krijimin dhe ndarjen e vlerës së posakrijuar ndërmjet pjesëmarrësve në punë (si rrogat për punëtorët dhe pjesëmarrja në rezultat-fitimi). Kuptimi i financimit të biznesit ka qasje të ndryshme varësisht nga aspekti së si e vështrojmë financimin. Ka shumë lloje të definicioneve për financimin dhe atë në kuptim të ngushtë dhe të gjerë.

Për të kuptuar më mirë problemet e financimit si dhe studimet krahasuese të këtij fenomeni nuk është e tepërt të fillojmë nga qëndrimet e autorëve gjerman nga se problematika e financimit ka rrjedhë nga kushtet kapitaliste të afarizmit.

Dallimi i parë bëhet midis financimit në kuptimin klasik dhe atij të gjerë. Në kuptim klasik financimi kuptohet si “furnizim i ndërmarrjes me kapital, ku kapitali nënkupton një sasi abstrakte të vlerës së pasurisë së investuar në ndërmarrje. Në bilanc paraqitet në anën e pasives”(Hax K.). Autori i njëjtë në kuptim të gjerë vlerëson si burim të financimit edhe procesin e qarkullimit. Sipas tij “financimi klasik ka të bëjë vetëm më ndryshimet në sferën e kapitalit të ndërmarrjes, ndërsa financimi në kuptim të gjerë ka të bëjë më ndryshimet në sferën e investimeve konkrete në pronë”.( V. Zeremski ).

Autori gjerman D. Härle, konsideron se “me financim kuptojmë vetëm ato kërkesa të cilat e tangojnë pasiven e bilancit: sigurimi i kapitalit, pagesat e kapitalit, dhe ndryshimi i strukturës së kapitalit.

Në raport me këtë duhet të bëhet dallimi i veprimeve afariste të cilat kanë të bëjnë me shfrytëzimin e mjeteve të siguruara në vetë ndërmarrje”.

Shumë autor më financim shprehin të gjitha veprimet për sigurimin e nevojshëm të mjeteve afariste.

Është interesant konstatimi i (Vaes U):” me financim kuptojmë vënien në dispozicion drejtuesve në ndërmarrje, në kohë dhe në mënyrë efikase, fonde të cilat iu nevojiten, duke siguruar pavarësi në veprim”.

Sellien H., jep këtë definicion: ”financimi është sigurimi i mjeteve vetjake dhe të huaja”.

Prof. Dr. Aristotel Pano në fjalorin ekonomik financiar, faqe 170, shkruan: “Financimi përfaqëson tërësinë e mënyrave dhe të veprimeve të sigurimit të burimeve (të fondeve, të kapitaleve) të nevojshme për një vepër investimi, themelimin e zgjerimin e një kompanie, si dhe përdorimin sa më efikas të këtyre burimeve në sektorin privat dhe publik, i cili funksionon sipas kriterit të sigurimit të fitimit. Mënyra e sigurimit të burimeve financiare (fondeve, kapitaleve) si dhe përdorimi i tyre më efikas ka rëndësi jetike për ekzistencën e njësive të veçanta ekonomike”.

Sipas Prof. Dr. Gazmend Luboteni, “me financim nënkuptojmë të gjitha veprimet e lidhura me sigurimin e mjeteve të domosdoshme afariste”. Ose “Me financimin e ndërmarrjeve nënkuptohet kërkimi dhe sigurimi i mjeteve të parashikuara me konceptin e politikës financiare dhe me planin financiar për realizimin e programeve afariste dhe të zhvillimit të caktuar”.

Prof. Dr. Isa Mustafa, thotë: “se burimet e financimit të një aktiviteti të caktuar ekonomik duhet të jenë në lidhshmëri me qëllimin për të cilin janë destinuar këto burime”.

Profesor Shaban Prevalla në librin e tij “Financimi i afarizmit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve”, citon autor : Financimi përfshin planifikimin, gjetjen, shfrytëzimin dhe kthimin e parave, kurse vetë proces paraqet funksionin financiar”.

Sipas fjalorit ekonomik të Maksim Konini-Ilia Peçi: “Financimi është tërësi masash për sigurimin dhe kthimin e mjeteve financiare si dhe për krijimin e marrëdhënieve financiare, të kontrollit, të informacionit dhe të sigurive ndërmjet ndërmarrjeve dhe subjekteve financuese”.

”Financimi i ndërmarrjes është proces i parë dhe shumë i ndërlikuar, me të cilin bëhet planifikimi, sigurimi dhe shfrytëzimi i mjeteve të nevojshme financiare për mirëvajtjen në mënyrë të rrjedhshme të procesit të punës”.(B. Ramosaj – I. Zeqiri)

Me një definim më të hollësishëm, “financimi përfshinë përcaktimin e nevojës për mjetet financiare, investimin, transformimin e mjeteve, riinvestimi, respektivisht kthimin e mjeteve në burimet e veta.”

\*Fig. 1- Skema e Financimit




Tabela 3 (burimi: Sherif Bundo;Financë-Tiranë-2004, faqe 184)

## Disa nga pengesat në afarizmin e NVM-ve dhe problemi që vihet re në financim

Mungesa e financimit është një ndër pengesat e konsiderueshme sipas anketës së: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Departamenti i PZHSP-së( Departamenti i zhvillimit të sektorit privat) “Hulumtimi i NVM-ve “ për Vitin 2005, në afarizmin e NVM-ve. Shih tabelën nr. 4:

<i>Pengesat në afarizëm të NVM-ve</i>	<i>Nuk paraqet pengese</i>	<i>%</i>	<i>Peng. e vogël</i>	<i>%</i>	<i>Pengese e madhe</i>	<i>%</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>%</i>
<b>Financat</b>	<b>500</b>	<b>27.8</b>	<b>154</b>	<b>8.6</b>	<b>1146</b>	<b>63.7</b>	<b>1800</b>	<b>100</b>
Pamundësia për marrjen e kredisë	354	59.0	106	17.7	140	23.3	600	100
Kamatat e larta	62	10.3	26	4.3	512	85.3	600	99.9
Afatet e kthimit të kredisë(të shkurta)	84	14.0	22	3.7	494	82.3	600	100
<b>Rrethina ligjore-administrative</b>	<b>558</b>	<b>31.3</b>	<b>286</b>	<b>16.1</b>	<b>936</b>	<b>52.6</b>	<b>1780</b>	<b>100</b>
Mungesa e ligjeve	72	12.0	98	16.3	430	71.7	600	100
Procedurat e licencimit (leja)	286	47.7	120	20.0	194	32.3	600	100
Korrupsioni në administratë	200	33.3	68	14.7	312	52.0	580	100
<b>Politika fiskale</b>	<b>214</b>	<b>17.8</b>	<b>242</b>	<b>20.2</b>	<b>744</b>	<b>65.0</b>	<b>1200</b>	<b>100</b>
Tatimet e Larta	94	15.7	156	26.0	350	58.3	600	100
Doganat e larta	120	20.0	86	14.3	394	65.7	600	100
<b>Politika ekonomike</b>	<b>254</b>	<b>21.2</b>	<b>178</b>	<b>14.8</b>	<b>768</b>	<b>64.0</b>	<b>1200</b>	<b>100</b>
Struktura e përgjith. ekonomike	24	4.0	62	10.3	514	85.7	600	100
Rrethanat e jashtme tregtare	230	38.3	116	19.3	254	42.3	600	99.9

Tabela 4; Rangimi i pengesave/barrierave në afarizmin e NVM-ve

Burimi: Të dhënat nga anketa e MTI-Departamenti i PZHSP

### **Problemet e bankierëve në lidhje me financimin e NVM-ve**

Institucionet financiare kredituese kryesisht shprehen se:

- Faktori i riskut të lartë për të kredituar NVM-ve
- Kosto e lartë e shpenzimeve administrative për kredit të vogla
- Shumë NVM-ve nuk kanë histori bankare
- Biznes planet janë të paqarta dhe jo të plota
- Kolaterali i pamjaftueshëm nga shumë NVM-e
- Shumë NVM-ve japin shifra financiare të pamjaftueshme

### **Pengesat e përdoruesve në lidhje me kredinë**

Shfrytëzuesit e kredive nga ana e NVM-ve, shprehen se: sistemi i kredisë në Kosovë nuk i mbulon nevojat adekuate për financim. Disa nga pengesat me të cilat ballafaqohen ata janë:

- Mungesa e kredive për zhvillimin e NVM-ve- kapitali investues afatgjatë
- Norma e lartë e interesit për kreditë
- Kërkesat për kolateral nga banka janë shumë të larta
- Procedurat kërkojnë kohë për të siguruar dokumentacionin e kërkuar në mbështetje të kërkesës për kredi
- Mungesa e burimeve alternative

Në çdo literaturë të konsultuar, rangimi i pengesave financiare për NVM-ve në Kosovë, në vazhdimësi është:

### **a. Pjesëmarrja në kapital**

- Mungesa e kapitalit vetjak (Mungesa e institucioneve të kapitalit të përbashkët dhe pajisjeve)
- Tatimet jo stimuluese për investime
- Rrjedhja e kufizuar e investimeve të huaja
- Fitimi i ulët në shumicën e bizneseve
- Sipërmarrësit janë ngurrues për të hyr në investime të përbashkëta.

### **b. Kreditë**

- Lartësia e kolateralit dhe kërkesave për garanci
- Grejs periudha të shkurtra të kthimit të kredive
- Shkalla e lartë e interesit
- Ofertë e varfër bankare
- Vështirësitë në qasje afatgjate financiare
- Ndjeshmëria e Bankave për rrezikun (riskun)
- Problemet ne përgatitjen e formave te aplikacioneve dhe dokumentet tjera lidhur me kredi ku përfshihet edhe biznes plani.

## Metodologjia

Për nevojat e hulumtimit vendosëm që të bëjmë një pyetësor në ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit.

Këtë pyetësor vendosëm që ta bëjmë për shkak që të jemi më të fokusuar në këtë temë sepse deri më tani kemi marrur materiale në përgjithësi për ndikimin e kredive në shtimin e punëtorëve në sektorin privat në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit mirëpo me këtë pyetësor do të jemi më të gatshëm që të dijmë :

Cfar ndikimi ka marrja e kredise nga bizneset e vogla dhe të mesme në shtimin e numrit të punëtorëve.

Ndikimi I marrjes së kredisë në zgjerimin e veprimtarisë tregtare, prodhuese apo shërbyese.

Sa janë të kënaqur bizneset e vogla dhe të mesme me kushtet që u ofrohen atyre për të marrur kredinë.

Intervistat që do ti bëjmë do të jenë te llojit të hapur dhe do të jenë ne gjuhën Shqipe . Pyetëtori do të përmban 50 intervista te cilat do ti bëjmë me disa nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ne Komunën e Lipjanit . Sfidat që janë për ti përmbushur këto intervista janë puna individuale duke e pasur parasysh se këto lloj pyetësorësh bëhen nga nje grup i caktuar dhe jo vetëm nga një individ,si dhe serioziteti I personave përgjefjës për tu përgjigjur në mënyren e duhur në pyetjet tona.

Pyetjet do të fokusohen me shume nga ndikimi I kredive ne shtimin e numrit të punëtorve ne ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe përparësitë dhe mangësite e marrjes së kredisë në zhvillim e biznesit. Për grumbullimin e informacioneve që do ti marrim nga të anketuarit do të përdorim forma të inçizimit dhe do të mbahen konfidenciale mirëpo po që se nuk pranojnë që të inçizojmë atëher do të provojmë që të marrim shënime nga ato se qka përgjigjen të anketuarit .



## Mbledhja dhe Analiza e të Dhënave

Ne për të arritur deri tek mbledhja dhe analiza e të dhënave e kemi bërë metodologjinë ku kemi bërë një pyetësor në gjuhën shqipe I cila ka përmbajtur 15 pyetje. Ne I kemi intervistuar 50 ndërmarrje private të vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit ku në këto ndërmarrje kanë marrur pjesë ndërmarrjet tregtare, prodhuese dhe shërbyese.

Ne arritëm të kuptojmë për përgjegjet për pyetjet e poshtëshënuara:

- Cfarë ndikimi ka marrja e kredive nga bizneset e vogla dhe të mesme në shtimin e numrit të punëtorëve.
- Ndikimi I marrjes së kredisë në zgjerimin e veprimtarisë tregtare, prodhuese apo shërbyese.
- Sa janë të kënaqur bizneset e vogla dhe të mesme me kushtet që u ofrohen atyre për të marrur kredinë.

Analiza e të dhënave do të ketë shqyrtimin e pyetësorëve dhe intervistave të bëra mirëpo me një përmbledhje të të gjitha intervistave dhe pyetësorëve në temën time në këtë hulumtim të bërë.

Qëllimi i këtij studim rasti ishte të kuptojmë më shumë ndikimin e kredive në shtimin e numrit të punëtorëve në sektorin privat në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit.

Në këtë fazë të hulumtimit të financimit të biznesit në Kosovë në mënyrë të përgjithshme do të definohet se cfarë ndikimi kanë kredite në shtimin e numrit të punëtorëve në ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme në Komunën e Lipjanit

Nga pyetësori që bëmë në komunën e Lipjanit në 50 ndërmarrje kuptuam se në shumicën e ndërmarrjeve bizneset e vogla dhe të mesme janë financuar me mjete vetanake dhe familjare mirëpo ka edhe ndërmarrje që janë financuar 50% me 50% pra gjysma kapital vetanak e gjysma me kredi.

Ne mësuam që ndërmarrjet private të vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit prej fillimit të veprimtarisë e deri më tani kanë marrur kredi e disa të tjera nuk kanë marrur. Në shumicën e ndërmarrjeve të pyetura kemi kuptuar se marrja e kredisë nga ndërmarrjet është marrur për zhvillimin e veprimtarisë afariste.

Ndërrmarrjet në komunën e Lipjanit marrjen e kredisë e shohin si mundësi për zhvillim mirëpo ka edhe mendime tjera që mendohet se me këto norma të larta financiare është mundësi për të dalur nga kriza, në periudhë afatshkurtër kurse në periudhë pak më të gjatë mund të futet në krize edhe më të thellë.

Në komunën e Lipjanit ndërrmarrjet mendojnë se në disa ndërrmarrje ka ndikim marrja e kredis në shtimin e numrit të punetoreve kurse në disa tjera nuk ka ndikim varet prej madhësisë së ndërrmarrjeve dhe destinimit të kredisë. Ndërrmarrjet që janë më të vogla ato marrin kredi për të dalur nga kriza financiare për arsye se mallin e shitur e lëshojnë edhe me borgj, kur borgjet vonohen atyre ju nevojiten mjete financiare për tu furnizuar me mall e rrugedaljen e vetme e gjejnë në marrjen e kredive për ta zhvilluar veprimtarin afariste të biznesit të tyre, ndërsa ndërrmarrjet pak më të mëdha ka ndikim marrja e kredisë në shtimin e punëtorëve ndoshta për here të parë kur merret kredia nuk ka apo ka ndikim me pak mirëpo kur të perseritet ajo dhe merret me afat më të gjatë atëherë mundësit që të shtohet numri i të punësuarve rritet.

Për normat kamatore të gjithë të intervistuarit janë të një zërit se normat kamatore janë shumë të larta me kushtet që janë në Kosovë dhe sikur të ishin normat kamatore më të ulta dhe kredite të ipen në një afat më të gjatë atëherë mundësia e perfitimit të ndërrmarrjeve është më e madhe e me këtë përfitojnë të gjithë si bankat që mundësia e mos kthimit të kredisë është shumë e vogël, ashtu edhe do të shtohet numri i të punësuarve në ndërrmarrje, po ashtu edhe qeveria do të kishte të hyra më të mëdha të vjelura nga taksat dhe tatimet nga ndërrmarrjet e mundësia e falimentimit të ndërrmarrjeve do të ishte minimale.

Diku rreth 50% e ndërrmarrjeve të intervistuar kane treguar se nuk kane marrur kredi arsyeja është se nuk ju nevojiten mjetet financiare edhe si arsye e dyte është se normat kamatore janë të larta dhe nese ju nevojiten mjetet financiare i gjejnë për një kohë të caktuar tek shoqëria dhe nuk kanë nevojë që të paguajnë kamat për paratë e shfrytëzuara mirëpo edhe gjysma ntjetër që ka mbet pra për dallim nga këta ata kanë marrur kredi dhe jo për herë të parë mirëpo e kanë përsëritur disa herë dhe kjo ka ndikuar që duke marrur kredi duke e zgjëruar kapitalin e duke u zgjëruar kapitali ndërrmarrja ka nevojë për punëtorë më shumë dhe përveq mikro ndërrmarrjeve ndërrmarrjet pak më të mëdha pra ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme dukshum kanë shtuar numrin e punëtorëve pra shumica ja kanë filluar me 2 apo 3 punëtor kurse tani numërojnë mbi 10 punëtorë.

Ne mësuam një rast kur një ndërrmarrje pas marrjes së kredisë për zgjerimin e veprimtarisë në vlerë prej 13.000 euro brenda një muaji ka falimentuar, pra kemi degjuar edhe raste tjera po asgje konkrete. Për arsye të konfidencialitetit ne nuk do ta përmendim emrin e firmes.

Ne dëshironim të dinim mendimin e të intervistuarve se a më të favorshme janë bankat apo institucionet mikro-financiare ne marrjen e kredive të gjithë të intervistuarit janë të mendimit se bankat janë më të favorshme në aspektin e kamatave kurse në aspektin e marrjes së kredive më të shpejta janë institucionet mikrofinanciare dhe procedurat janë më të lehta.

Dokumentet që kërkohen për aplikimin e kredisë nga bankat janë pak të lodhshme dhe marrin kohë mirëpo varet edhe nga shuma e kredisë së marrur sepse deri në shumën prej 10.000 eurove janë më të lehta kurse mbi këtë shumë procedurat janë më të gjata dhe më të lodhshme për arsye se ndërrmarrjet duhet të lënë hipotek për marrjen e kredisë e hipoteka

njëher duhet të shkohet në gjyq që të verifikohet e pastaj verifikohet në komunë dhe vonohet diku rreth një javë.

Bankat kryesore në komunën e Lipjanit janë Pro-credit banka, Raiffaizen banka dhe NLB Prishtina. Disa ndërmarrje kanë kredi te një bankë dhe kanë të hapur over-draftin te një bankë tjetër këto informacione i kemi mësuar gjatë intervistave të bëra me intervistuesit.

Ndërmarrjet në komunën e Lipjanit thoksojnë se kamatat më të volitshme i ka banka me të cilën ata bashkëpunojnë dhe kanë pak informacione për bankat tjera dhe normat më të lira kamatore mirëpo sipas mendimit të disa ndërmarrjeve shumica pajtohen se në komunën e Lipjanit Banka NLB-Prishtina ka kamatat më të volitshme.

Marrja e kredisë ka ndikim në zvoglimin e papunësisë në komunën e Lipjanit sepse kur ka ndikim në rritjen e veprimtarive të ndërmarrjeve private dhe kur ndërmarrjet fillojnë të rrisin fuqin punëtore në ndërmarrjet e tyre atëher normal se ka ndikim marrja e kredisë në zvoglimin e papunësisë edhe në komunën e Lipjanit

Ndërmarrjet për institucionet mikrofinanciare mendojnë se janë të lehta për marrjen e kredisë mirëpo kanë kamata 2 herë më të larta në krahasim me bankat komerciale. Institucionet mikro-financiare kanë sukses në lëshimin e kredive më shumë te personat që nuk kanë qasje nëpër banka dhe mund të marrin kredi bujqesore, kredi për gra etj.

.

## **Bankat Komerciale**

Mundësia e financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është marrja e kredive nga 7 bankat komerciale që janë të licencuara nga banka qendrore e Republikës së Kosovës, e ato janë:

### **Banka Ekonomike**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare /Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare; Transferë të Parave

### **Banka për Biznes**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare, Transferë të Parave

### **Pro Credit Bank**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare

### **NLB Prishtina**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare, Transferë të Parave

### **Raiffeisen Bank Kosovo**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare, Transferë të Parave

### **Banka Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë**

Aktivitetet: Punë bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare, Transferë të Parave

### **TEB sh.a.**

Aktivitetet: Pune bankiere;

Llogari rrjedhëse, Llogari kursimi dhe Depozita të afatizuar, Kredi, Garancione Bankare / Letra të Kredive, Produkte tjera tregtare financiare, Transferë të Parave.

Mundësia e financimit është edhe nga institucionet mikrofinanciare.

**Institucioni jo-bankar mikrofinanciar (IMF)** është i definuar si organizatë që ofron shërbime financiare të varfërve që janë ekonomikisht aktiv dhe një pjesë e aseteve të tyre janë të lidhura ngushtë me shërbime financiare për të varfërit.

Duke e vlerësuar mundësinë dhe rëndësinë e mësimit të përbashkët, IMF-ët e panë nevojën për një asociacion që do të koordinonte aktivitete të ndryshme të përbashkëta dhe që do të avokojnë për nevojat e tyre. Kështu formuan **AMIK-un** (asociacion i institucioneve mikro financiare), i cili ka qëllim t'i ndihmojë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe krijimit të vendeve të lira të punës duke përkrahur sektorin mikrofinanciar në Kosovë.

AMIK-u përkrah zhvillimin e fuqishëm dhe efektiv të programeve për zhvillimin e bizneseve të vogla të Kosovës që kanë për qëllim ndihmesën e ndërmarrësve që nuk kanë ndonjë asistencë në fillimin, stabilizimin dhe zgjerimin e bizneseve. **Aktualisht, janë dhjetë institucione anëtare në AMIK.**

## **Institucionet Mikro Financiare**

### **Agency for Finance in Kosovo**

Aktivitetet: Kreditimi;  
Kredi bizneseve të vogla, bujqësi, përpunim, prodhimtari dhe shërbime tjera të kredive.(anëtare e AMIK)

### **Atlantic Capital Partners ACP**

Aktivitetet: Kreditimi;  
Kredi për hipotekë (anëtare e AMIK)

### **Balkanactie**

Aktivitetet: Kreditimi;  
Kopshtari, produkte të qumështit si dhe shërbime tjera të kredive.

Në bazë të kërkesës së institucionit më 26 Qershor 2008, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka tërhequr regjistrimin e BALKANACTIE si institucion mikro-financiar.

### **Beselidhja**

Aktivitetet: Kreditimi;  
Biznese të vogla, bujqësi, kredi pengu dhe shërbime tjera të kredive.(anëtare e AMIK)

**Qelim Kosovë**

Aktivitetet: Kreditimi;

Solidaritë, bujqësi, ferma, zejtari, tregti dhe shërbime tjera të kredive. (anëtare e AMIK)

**Cordaid**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kreditimi i fshatrave, biznese të vogla , kredi bujqësore.

**FINCA**

Aktiviteti : Kreditimi;

Kreditimi i fshatrave- kredi grupore , kredi individuale- biznese, kredi për përmirësimin e kushteve të banimit dhe kredi rurale (anëtare e AMIK)

**KEP Trust**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kredi solidariteti, kredi individuale dhe kreditimi i fshatrave.(anëtare e AMIK)

**KGMAMF**

Aktivitetet: Kreditimi;

Bujqësi, produkte të qumështit, kredi tregëtare, si dhe kursime.(anëtare e AMIK)

**KosInvest World Vision**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kredi grupeve solidarë, kredi individuale të biznesit, kredi bujqësore.

**Kosova Aid and Development**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kredi bizneseve të vogla, kredi për tregti ,prodhim, bujqësi.

**Kreditimi Rural i Kosoves**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kreditimi i fshatrave, kredi bizneseve të vogla, kredi bujqësore, kredi individuale.(antare e AMIK)

**Meshtekna**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kreditimi i fshatrave, kreditimi i biznesit individual, kredi prodhuese, tregtare, bujqësore.

**Perspektiva 4**

Aktivitetet: Kreditimi;

Kredi bujqësore, zejtare, tregtare

**Start**

Aktivitetet: Kreditimi

Kredi bujqësore, zejtare, tregtare.(anëtare e AMIK)

## Përfundimi

Në këtë hulumtim për temë të diplomës une kam marrur temën e financimit të biznesit të vogel dhe të mesëm e më konkretisht qëllimi I këtij studimi ka qenë ndikimi I kredive në shtimin e numrit të punëtorëve në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Komunën e Lipjanit.

Ne në fillim kemi hasur në probleme për material për arsye se nuk kishte material specific për temën time mirëpo me formulimin e pyetësorëve dhe me intervistat e bëra kemi arritur që të kuptojmë më shumë në lidhje me ndikimin e kredive në shtimin e punëtorëve në ndërmarrjet e vogla dhe te mesme në komunën e Lipjanit.

Në këtë punim rol të madh kanë luajtur bankat dhe ndërmarrjet, pra ndërmarrjet kanë shkuar për të marrur kredi në banke dhe kjo ka ndikuar në zgjerimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve e me këtë edhe në shtimin e numrit te punëtorëve. Të gjitha ndërmarrjet e intervistuarra kanë theksuar se kamatat janë shumë të larta dhe sikur të ishin kamatat më të ulta dhe me një afat kthimi më të gjatë atëher mundësia për tu zvogëluar papunësia në komunën e Lipjanit do të ishte shumë më e madhe.

Në shumicën e rasteve ndërmarrjet janë financuar me kapital vetanak dhe një përqindje më e vogel 50 me 50 do të thotë gjysma Kapital vetanak e gjysma me kredi.

Marrja e kredisë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Lipjanit prej bankave komerciale kanë ndikuar dukshëm në zvoglimin e papunësisë në komunën e Lipjanit. Ne të dhëna të sakta se sa ka ndikuar nuk kemi mirëpo në ndërmarrjet që I kemi intervistuar kemi mësuar se ka ndikuar marrja e kredisë në shtimin e numrit të të punësuarve në ndërmarrjet e tyre ku në shumicën e ndërmarrjeve fillimin e veprimtarisë biznesore e kanë filluar 2 apo 3 persona kurse duke marrur kredi dhe duke e përsëritur atë ata kanë filluar ta rrisin veprimtarinë e tyre ekonomike dhe po ashtu edhe numrin e punëtorëve në ndërmarrjet e tyre. Pra prej fillimit të veprimtarisë ku kanë filluar me 2 apo 3 punëtorë e deri më tani kur kemi bërë intervistat pra pas përsëritjes së kredisë se 2-të apo te 3-të ata numërojnë mbi 10 punëtorë në ndërmarrjet e tyre. Pra me rritjen e numrit të punëtorëve në këto ndërmarrje atëher ky efekt ndikon në përgjithësi edhe në komunën e Lipjanit duke ndikuar që sadopak ta ulë normën e papunësisë në këtë komunë.

Ndërrmarrjet në komunën e Lipjanit ankohen për kamata të larta dhe thonë se sikur të ishin kamatat më të ulta ne do të kishim mundësi që të rrisim edhe me tutje bizneset tona e me këtë do të punësoheshin edhe shumë persona tjerë sepse për momentin normat e kamatave janë shumë të pa favorshme për bizneset mirëpo për shkak të nevojave financiare që kanë ndërrmarrjet duhet të marrin kredi që ti përmbushin nevojat e tyre.

Rol të rëndësishëm në marrjen e kredive kanë edhe institucionet mikro-financiare ku edhe ato ashtu si edhe bankat e shesin paran e tyre dhe si kundërshpërblim marrin kamatën per paran e shitur. Këto institucione mikro-financiare dallohen nga bankat sepse kanë kamata shumë më të larta diku rreth 2 herë më shumë mirëpo kanë procedura më të lehta dhe janë më të shpejta se bankat deri te lëshimi I kredisë.

Në uljen e kamatave mund të këtë rol edhe qeveria ku me mjetet e marra nga privatizimi I ndërrmarrjeve publike si dhe fondeve pensionale që janë të dërguara nëpër bankat e evropes, ajo mund ti kthej ato në Kosovë dhe ti dërgoj në bankën qendrore të republikes së Kosovës ku ajo mund ti jep bankave komerciale këto para me kamata më të ulta për ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme e më konkretisht në disa sektore të caktuar që të ndikoj më shumë në rritjen e numrit të punëtorëve ku kjo ndikon edhe në ndërrmarrjet e vogla dhe të mesme ku shtohet edhe profiti I tyre, përfiton edhe komuna sepse ulet papunsia e nuk paguan sociale për personat që nuk kanë kurfar të ardhurash e në fund përfiton edhe shteti në përgjithësi.

Ne mësuam edhe për tri bankat më të sukseshme në komunën e Lipjanit te cilat jane pro credit-bank, raiffaizen bank dhe Nlb Prishtina. Ne vazhdim do ti tregojme dy lloje te kredive te cilat jane kredi biznesi per ndermarrjet e vogla dhe te mesme dhe kredi per bujqesi.



## Kredi Biznesi për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

Me Kredi biznesi (tani edhe deri ne 10 vite), ju keni mundësi të planifikoni rritjen dhe zhvillimin e biznesit tuaj.

<b>Shuma</b>	Mbi 10,000 EUR
<b>Valuta</b>	Euro
<b>Kohëzgjatja e kredisë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• për kapital punues deri 36 muaj</li><li>• për mjete fikse dhe qëllime të ndryshme biznesi deri në 84 muaj</li><li>• për blerje të patundshmërisë (objekt biznesi/tokë/shtëpi)</li></ul>
<b>Mjetet e sigurisë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• një garantues</li><li>• për kredi më të madhe se 50 000 Euro ose kohëzgjatje mbi 60 muaj Hipoteka është e nevojshme</li></ul>
<b>Të keni biznes aktiv minimumi</b>	6 muaj
<b>Mënyra e pagesës</b>	pagesa të rregullta mujore <ul style="list-style-type: none"><li>• Grejs perioda dhe pagesat e parregullta aplikohen vetëm në raste të veçanta deri në 120 muaj</li></ul>
<b>Disbursimi</b>	5 ditë

## Kredi për Bujqësi

Me kredi për bujqësi ju mund të: përgatiteni për sezonin e mbjelljeve, të zgjeroni fondin e bagëtisë, të rregulloni fermën tuaj, të blini pajisje bujqësore të gjitha këto me kushte të volitshme të kthimit të kredisë.

<b>Shuma</b>	minimumi EUR 250
<b>Valuta</b>	Euro
<b>Kohëzgjatja e kredisë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• për kapital punues deri në 36 muaj</li><li>• për mjete fikse dhe qëllime të ndryshme biznesi deri në 48 muaj</li></ul>
<b>Mjetet e sigurisë</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• vetëm një bashkëhuamarrës (anëtar i familjes)</li><li>• deri në 10 000 Euro pa garantues</li><li>• mbi 25 000 Euro kërkohet Hipoteka</li></ul>
<b>Të keni biznes aktiv minimumi .</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Një sezonë të prodhimit eksperiencë (të akumuluar) në biznes të aktivitetit fermë.</li></ul>
<b>Mënyra e pagesës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• pagesa bëhet në bazë të shitjes së produkteve tuaja</li><li>• Grejs periudha dhe pagesat e pa rregullta lejohen</li></ul>
<b>Disbursimi</b>	48 orë

## Shtesat

### Cilat jane alternativat e financimit bankar?

**Fondet e investimeve - Kapitali ndërmarrës-investues.(venture capital, equity capital),** është formë e re e cila ka për qëllim përmirësimin e kushteve të financimit të Biznesit të Vogël dhe të Mesëm. Kjo formë ndërlidhet me financimin e kapitalit themelues dhe paraqet një kombinim midis pjesëmarrjes në investim të përbashkët dhe huasë. Kjo nënkupton së një pjesë e financimit bëhet përmes kredisë e një pjesë përmes pjesëmarrjes në investim. Fondet e Investimeve (Venture Capitalist Fund), janë fonde të menaxhuara nga profesionistë të cilët investojnë në kompani të reja, me rritje të shpejtë dhe potenciale për një kthyeshmëri të lartë të investimit. Pra, janë një alternativë në zhvillimin e sektorit prodhues dhe shërbimeve.

Edhe pse në pamjen e parë duken se janë të njëjta, këto dy forma të kapitalit dallojnë.

**Equity capital** ka filozofinë e investimit të mjeteve në afarizmin ekzistues, firmat të cilat kanë përvojë të suksesshme shumë vjeçare dhe zakonisht fjala është për zgjerim të kapaciteteve apo për projekte të reja. Partneri, fondi investues është i interesuar për kthim në periudha të gjata kohore me rrezik të vogël.

Dallimi midis financimit me borxh dhe financimit me equity capital është se: financimi me borxh nënkupton sigurimin e mjeteve për financimin e biznesit duke e paguar atë në periudha të caktuara së bashku me kamatën (çmimi për mjetet e huazuara), pronari i mjeteve të huazuara nuk hynë në marrëdhënie pronësore me huamarrësin. Kjo formë e financimit është e siguruar me kolateral. Equity capital, paraqet asilloj financimi të biznesit ku investitori investon mjetet e veta dhe si kompensim për investimin e bërë ka një shkallë të kontrollit mbi ndërmarrjen. Nuk ka borxh dhe kamata, por ka ndarje të përbashkët të fitimit apo humbjes.

E kundërta e kësaj janë fondet venture capital. Është e rrugës të ceket së investitorët e venture capital mbesin në biznes në një periudhe kohore relativisht të shkurtër i cili matet më 3 (tre) deri në 5 (pesë) vjet.

Venture Capitalist Fund kanë filluar jetën e tyre në vendet e zhvilluara perëndimore relativisht vonë krahasuar me burimet e tjera tradicionale të financimit të ndërmarrjeve, psh. në Shtetet e Bashkuara të Amerikës fillimet e tyre i kanë në vitet '60 –ta dhe '70-ta. Zakonisht Venture Capitalist Firms (VCF) janë forma private ortakërie ose kompani që zotërohen nga një numër i vogël aksionarësh. Ato financohen nga fonde publike dhe private, fondacione, kompani, individë të pasur, investitorë të huaj, banka, institucione financiare, etj, dhe normalisht operojnë gjatë një periudhe kohore të përcaktuar, zakonisht 10 vjet.

Kompani si Digital Equipment Corporation, Apple, Federal Express, Compaq, Sun Microsystems, Intel, Microsoft dhe Genentech janë shembuj të famshëm të kompanive që i kanë financuar me kapital në fazat e hershme të zhvillimit të tyre. Në përgjithësi Venture Capitalist Funds financojnë kompani, që janë në hapat e para të zhvillimit të tyre dhe premtojnë një rritje të shpejtë. Gjithashtu marrin risk të lartë duke kërkuar dhe një fitim të lartë, me një orientim afatgjatë në investimet e tyre.

Filozofia nga e cila udhëhiqet Fondi në aktivitetin e tij është: idetë e suksesshme për zhvillimin e biznesit dhe menaxherët e aftë. Si formë specifike e financimit të investimeve në Kosovë, veçojmë KREF-in (Kosovo Reconstruction Equity Fund) i cili dallon nga institucionet e tjera financiare (kryesisht bankat tregtare).

Pse në Kosovë nuk janë prezentë këto forma të Venture Capitalist Firms (VCF)?

Sepse :

1. Konsiderojnë se investimet janë ende jo tërheqëse për investitorë privatë ose institucione private që si synim primar kanë fitimin.
2. Fondet e investimeve mund të financohen vetëm nga investitorë institucional të cilët synojë të kontribuojnë në zhvillimin e vendit përveç së të rrisin fitimet e tyre.

Arsyet janë:

- (1) mungesa e një tregu financiar të zhvilluar (bursa) ku do të shiteshin lirisht kapitalet,
- (2) mungesa e kulturës së bashkëpronësisë dhe transferimit të saj të sipërmarrësit kosovarë,
- (3) mos stabiliteti i vendit kërcënon sidomos aktivitetet që janë në hapat e para të zhvillimit të tyre.

Sidoqoftë në Kosovë, Venture Capitalist Funds në të ardhmen do të kenë një rol të veçantë.

Disa nga kontributet e veçanta të tyre janë burime financimi dhe për aktivitete të stabilizuara dhe në rritje të shpejt, por që në një treg konservativ kreditimi preferojnë të financohen me kosto më të lartë nga VCF. Ky grup normalisht në vende të zhvilluara i drejtohet bankave. Fondet këshillojnë menaxheret që të investojnë në ato aktive të cilat e rrisin më shumë IRR, si investimet në makineri, know-how, teknologji, emër të mirë, etj. fondet bëjnë të mundur dhe gjallërimin e Bursës

## Burimet alternative të financimit të ndërmarrjeve

Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme paraqet një nga çështjet më të diskutuara. Ndërmarrja varësisht nga fazat e zhvillimit të saj ka nevojë për burime të ndryshme financiare. Në fazën e zanafillës, ndërmarrja financohet nga vetë themeluesi, familja, miqtë dhe metodat tjera kreative për sigurimin e mjeteve financiare, që në literaturën bashkëkohore njihen si “3F money”. Ashtu siç rritet ndërmarrja e vogël sipërmarrëse, rritet edhe nevoja për kapital plotësues. Në këtë rast investitorët joformal, të a.q. “Business angels”, konsiderohen si burim kryesor i financimit. Financat nga tregu zyrtar i risk-kapitalit hyjnë në fazat e më vonshme të zhvillimit, ku si burime të mundshme mund të konsiderohen personat privat, fondet pensionale dhe kompanitë e sigurimit, të cilat nuk i miratojnë vetë vendimet për investime, por punojnë përmes ndërmjetësve profesional, përkatësisht nëpërmjet firmave për risk-kapital. Kështu, aktorë të ndryshëm në mënyrë suksesive plotësohen midis vetes, reciprokisht me zhvillimin e ndërmarrjes. Hyrja e pjesëmarrësve të rinj nuk do të thotë se pjesëmarrësit e mëparshëm zhduken, por mbeten në prapavijë si partnerë më shumë ose më pak të heshtur.

## Engjujt e biznesit - “Business angels”

“Business angels”, si nocion paraqitet kah fundi i shekullit XIX. “Business angels” janë investitorë privat, shumë të pasur (milionerë), të cilët investojnë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat nuk janë të listuara në bursë, kryesisht në fazat e hershme të zhvillimit të tyre me qëllim që t’i ndihmojnë sipërmarrësit e rinj në realizimin e caqeve të tyre, si dhe për realizimin e fitimeve për vete. “Business angels” si burim joformal, paraqesin forcë të rëndësishme në financimin e ndërmarrjeve të sapo formuara. Rëndësia e tyre rritet edhe më tej me faktin që kontributi i tyre përbëhet edhe nga lloji i aftësive të ndryshme menaxheriale dhe sipërmarrëse.

Si rezultat i raporteve reciproke midis ofertës dhe kërkesës për kapital shtesë, sipërmarrësi ballafaqohet me dy hendeqe financiare. Hendeku i parë financiar, paraqitet kur ndërmarrja e vogël, e cila kërkon mjete duhet t’i identifikojë investitorët, pasi që vetë sipërmarrësi ta përkrahë ndërmarrjen.

Tregu i “Business angels” relativisht është pjesë e padukshme e tregut të përgjithshëm të risk-kapitalit. Në fazën fillestare investimet nga “Business angels” konsiderohen si “smart money”(para e mençur) sepse shumica e investimeve shoqërohen nga lloje të ndryshme të përkrahjes jofinanciare. “Business angels” sigurojnë ndihmë në sfera të ndryshme, si p.sh. të formimit të strategjisë së biznesit, hulumtimin e mjeteve plotësuese financiare, rekrutimin e personelit kyç, dizajnimin e planeve dhe modele të biznesit, inkuadrimin e sipërmarrësve në rrjetet profesionale etj

Në fazat e mëvonshme të zhvillimit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pasi që bëhen të njohura në treg, zgjerojnë veprimin e vet jashtë vendit, ofrojnë produkte, të cilat janë të njohura dhe shumë të kërkuara në treg, ato tek mjetet plotësuese financiare mund të arrijnë edhe përmes të ashtuquajturave oferta initiale publike (*Initial Public Offering-IPO*).

*Oferta publike iniziale* paraqet emisionin e parë të letrave me vlerë të një firme. Në rastin e një oferte publike për shitje, oferta fiton publicitet të gjerë dhe me këtë rast ftohen investitorët të bëjnë kërkesë për letra me vlerë. Në SHBA nëse letra e re me vlerë u është shitur më shumë se 25 blerësve, ajo atëherë bëhet emision publik i letrave me vlerë. Ofertat iniziale publike, përveç sigurimit të kapitalit plotësues, sigurojnë edhe mundësinë e tërheqjes së huave plotësuese financiare. Nga ana tjetër, ekzistojnë faktorë të shumtë lidhur me ofertat publike që i bëjnë ato të padëshirueshme.

Ajo çka i dallon “engjëjt e biznesit” nga investitorët klasik është, së ata pos parave investojnë edhe dijen (knoë hoë).dhe përvojën drejtuese në kompaninë të cilën e kanë zgjidhur.”Engjëjt e biznesit” nuk investojnë asnjëherë në biznesin familjar por kërkojnë biznese të suksesshme. Zakonisht për investimin e bërë ata fitojnë 25% deri 60% të aksioneve.



## Literatura e shfrytezuar dhe e konsultuar

- Kliford M. Bombek, “Bazat e drejtimit te biznesit te vogël”, *SHBLU* Tirane 1994;
- Prof. Shaban Prevalla, “Financimi i afarizmit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve,” Shkup, 1999;
- Prof.dr. Berim Ramosaj & Doc. Dr. Izet Zeqiri, “Managment - Udheheqja dhe menaxhimi financiar i ndërmarrjes ekonomike”, *Dukagjini* Prishtinë, 2003;
- Prof.dr. Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”. *Pegi*, Tiranë, 2005;
- Prof.dr. Halit Xhafa & Prof.dr. Beshir Ciceri, “Drejtimi Financiar 1”, *albPAPER*, Tiranë, 2006;
- Prof.dr. Isa Mustafa, “Menaxhmenti Financiar”, *Riinvest*, Prishtinë, 2005;
- Prof.dr. Aristotel Pano, Fjalor Ekonomik-Financiar, Botues *Albin*, Tiranë, 2002;
- MTI, “Investing in Kosovo”, Prishtinë 2005;
- Grup autoresh, “Biznesi i vogël dhe i mesëm”, *Riinvest*, Prishtine 2006;
- MTI, “Fillimi dhe bërja e një biznesi”, Prishtine 2004;

### **Adresat ne internet:**

- BQK, Banka Qendrore e Kosovës([bqk-ks.org](http://bqk-ks.org))
- Ministria e tregtise dhe industries(MTI-ks.org)
- Oda ekonomike e Kosoves ( [oek-kcc.org](http://oek-kcc.org))
- [www. Telegrafi.com](http://www.Telegrafi.com)
- [www.wikipedia.com](http://www.wikipedia.com)

